



Erion Fejzulla është zgjedhur anëtar i Këshillit të Lartë të Prokurorisë në tetor 2024 nga Kuvendi i Republikës së Shqipërisë nga radhët e shoqërisë civile.

Z. Fejzulla ka përfunduar studimet në Fakultetin e Drejtësisë, Universiteti i Tiranës në vitin 2005 dhe studimet Master për "Të Drejtat e Njeriut dhe Demokracinë në Evropën Juglindore" në Qendrën për Studime Multidisiplinore "Prof.Dr. Zdravko Grebo" në vitin 2006. Aktualisht po ndjek studimet doktorale në Fakultetin për Qeverisje dhe Çështje Globale, Universiteti i Leiden.

Ai është angazhuar aktivisht me disa organizata të shoqërisë civile, vendase dhe të huaja, në pozicionin e Drejtorit Ekzekutiv ose ekspertit, duke u përfshirë në aktivitete që lidhen me shtetin e së drejtës, sistemin e drejtësisë dhe të drejtat e njeriut.

Gjatë më shumë se 16 viteve, z. Fejzulla ka punuar në projekte të shumta në mbështetje të institucioneve publike si Ministria e Drejtësisë, Ministria e Integritimit Evropian, Prokuroria e Përgjithshme, Këshilli i Lartë Gjyqësor dhe Shkolla e Magjistraturës. Ai ka ofruar asistencë teknike në zhvillimin dhe zbatimin e politikave në sistemin e drejtësisë, hartimin e legjislacionit dhe përafrimin, si dhe në forcimin institucional dhe ndërtimin e kapaciteteve të institucioneve të drejtësisë.

Gjithashtu, z. Fejzulla ka kontribuar në Kosovë duke mbështetur Ministrinë e Integritimit Evropian, Ministrinë e Punëve të Brendshme, Ministrinë e Drejtësisë dhe Zyrën e Kryeministrit në hartimin dhe zhvillimin e dokumenteve programore në fushën e drejtësisë dhe çështjeve të brendshme.

Gjithashtu, ai ka bashkëpunuar me donatorë të ndryshëm dhe organizata ndërkombëtare si BE, Këshillin e Evropës, USAID, OSBE, UNDP, GIZ, IRZ, etj.

Me përvojën dhe angazhimin e tij, z. Fejzulla vazhdon të kontribuojë në avancimin e sistemit të drejtësisë dhe promovimin e të drejtave e njeriut në Shqipëri dhe rajon.